

Komuna e Istogut/Istok

Bajram (Binak) Alijaj

(25.05.1961, shqiptar nga Sushica/Sušica, komuna e Istogut/Istok, bujk, tetë fëmijë)

Bajrami me bashkëshorten Asen dhe fëmijë kanë jetuar në Sushicë/Sušica. Më datën **5.06.1998**, në mëngjes, rreth orës 07:00, Bajrami u nis për në Istog/Istok, për ta kontrolluar dorën e thyer dhe për t'i blerë ca gjësende. Nuk u kthye më në shtëpi. Familja e ka kërkuar dhe është interesuar gjithandej për fatin e tij, por pa sukses. Më datën 13.06.1998, trupin e gjymtuar të Bajramit, pa kokë dhe duar, e kanë gjetur disa të rinj në pyllin e fshatit **Uçë/Ukča**. E kanë identifikuar në bazë të letërnjoftimit. I ati Binaku, po atë ditë, e ka bartur trupin e të birit në Sushicë/Sušica dhe e ka varrosur në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata A.A, FDH-19509; KKMRFJ, *Personat...*, FDH-10832; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817.

Rajko (Božidar) Gajić

(16.02.1961, serb nga Veriq/Verić, komuna e Istogut/Istok, automekanik, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Rajko Gajić për një kohë ka punuar si shtëpiak në konviktin e studentëve në *Karaburmë*, në Beograd. Më pas ka shkuar për punë të përkohshme në Rusi. Me tu kthyer nga Rusia iu bashkua Gardës Vullnetare Serbe, ndërsa më pas edhe Bereta-ve të Kuqe. Mori pjesë në luftërat në Kroaci dhe BdheH. Pas luftës në BdheH edhe një herë ka shkuar në Rusi, ndërsa në vitin 1997 u kthye në Veriq/Verić. Ka jetuar vetëm në godinën e shkollës fillore. Nga vi-

ti 1997, ishte në përbërje të forcave rezervë të policisë. Në qershor të vitit 1998, ishte i angazhuar në postbllokun policor në fshatin Rakosh/Rakoš. U vra më **16.06.1998**, pasmesnate, para hyrjes në banesë [**Veriq/Verić**]. Obduksioni ka konstatuar se mbi trupin e tij ishin shtënë 37 plumba. Rajko u varros më datë 18.06.1998, në varrezat e fshatit Veriq/Verić.

Burimet: deklarata D.G, FDH-29733; deklarata M.Z, FDH-11158; deklarata J.Đ, FDH-5504; deklarata A.R, FDH-7138; KKMRFJ, *Personat...*, FDH-10832; FHP, *Haški tribunal, Sudeње Slobodanu Miloševiću*, XVIII, 255; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 21; SMIP, *Teroristički...*, III, 934; *Dnevnik od 9. do 16. juna*, Ilustrovana politika, jun 1998, <http://www.politika.rs/ilustro/2057/drugi.htm>

Slavko (Aleksandar) Škrkić

(8.09.1957, serb nga Beogradi, vozitës)

Slavoljub (Vladimir)

Grozdanović

(6.01.1961, serb nga Rakoshi/Rakoš, komuna e Istogut/Istok, punëtor, katër fëmijë)

Slavoljubi, i quajtur Slavo, deri në vitin 1985, ka jetuar dhe punuar në Beograd. Atëherë u kthye në vendlindje në fshatin Rakosh/Rakoš. Ka punuar në ndërmarrjen *Juko* në Dubravë/Dubrava. Nga viti 1997, ishte pjesëtarë i forcave rezervë të policisë në Istog/Istok. Kumbara i Slavoljubit, Slavko, ka jetuar në lagjen *Kalugjericë* në Beograd. Punonte në ndërmarrjen *Inex Napredak*. Prindërit e tij jetonin në Kosovë, në fshatin Kërrninë /Krnjina.

Në mbrëmjen e datës 25.06.1998,